



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 13.12.2024

Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik “Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin e vitit 2025” të Bashkiasë Pukë

Titulli i Projekt-aktit : “Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin e vitit 2025”

Grupet që u konsultuan: Banorët e të gjitha Njësive Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime : 129 persona, nga të cilët 17 gra dhe vajza

Numri i rekomandimeve: 48

Rekomandimet dhe kërkesat e dhëna nga qytetarët në takimet publike ishin kryesisht mbi:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale,
- Mirëmbajtjen e urave ekzistuese në fshatra dhe ndërtimi i urave të reja,
- Rikualifikim urban në disa lagje të qytetit
- Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik,
- Mirëmbajtja e kanaleve vaditëse dhe rendeve të ujit dhe ndërtimi i rendeve të reja
- Përmirësimin e shërbimeve publike, ujësjellësi në disa fshatra,
- Përmirësimin i sinjalistikës rrugore,
- Mirëmbajtjen e varrezave publike,
- Me shumë fonde dhe vemendje për emergjencat civile

Të gjitha informacionet për konsultimet e publikun janë publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen web dhe facebook të Këshillit Bashkiak.

Procesverbal

Konsultim publik : *Ne Njesine administrative Gjegjan*

Data : 24.10.2024

Ora : 13:00

Vendi: Salla e njesise administrative Gjegjan

Numri i pjesëmarrësve : *33 vete 30 burra dhe 3 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Konsultime publike per PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 , NJ.A.Gjegjan.*

Pjesëmarrës : *Rrok Dodaj , kryetar i Bashkise Puke, ndue Suma, zv/kryetar, Altin Perdeda zv/kryetar, Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, Demir Syla drejtori i sherbimeve publike , Nail Alia , she fi sektorit te Tatim-taksave, Hazbi Terbuni , sekretar i keshillit bashkiak, Paulin Lalaj , administrator i Nj.A.Gjegjan.*

Takimi drejtohet nga kryetari i Bashkise , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024 dhe prioritetet per vitin 2025, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z. Paulin Lalaj , administrator i njesise administrative Gjegjan: *sot po zhvillohet ky bashkebisedim per PBA 2025-2027 dhe kerkoj, qe gjithsecili te prezantoj prioritetet per fshatin e tij, megjithese ne si njesi i kemi pergatitur te specifikuar per secilin fshat nevojat per nderhyrje, qe do te perfshihen ne prioritetet e bashkise per sherbime dhe investime.*

Z. Rrok Dodaj : *Po shpalosim prioritetet per vitin 2025 dhe sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024.*

- Problem shqetesues mbetet punesimi, por duhet thene se Bashkia ka nje problem te trashегuar nga paraardhesi , nje borxhe , qe krijon mjaft veshtersi per vijimsine e puneve.

- Hartimi i projekteve është në vëmendjen e bashkësive për të realizuar investime dhe për të krijuar mundësi punësimit.
- Me mjaftë rendësi do të jete zhvillimi i turizmit , për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm.
- Përfundimi i ujesjellesit dhe qendres shëndetësore me bashkefinancim me bashkinë është siguruar një ambulançe e re për qendrën shëndetësore Gjegjan.
- Shërbimet në këtë njësi janë kryer mirë.
- Ndotja e mjedisit nga Miniera është mjaft problematike.
- Riparimi i ures në Rras do të nderhyhet nga Bashkia.
- Rikonstruksioni i tregut të qytetit do të shërbejë edhe për banorët e kësaj njësie.
- Lidhja e qendrave të fshatrave me rrugën nacionale do të jete objektivi i yni.
- Ngritja e terreneve sportive për shkollat dhe banorët
- Identifikimi dhe mbështetja e familjeve në nevojë.

Z. Ndue Ndreka: Rruga e Haxhiajve duhet të shtrohet me çakull dhe mbështetja me riparime për infrastrukturën e nevojshme.

Z. Ndoc Vorfi : Janë bërë shumë shërbime, kemi mangësi për ujë të pijshëm dhe për vegla pune, karroca, lopata, kamionçinë,

Z. Leonard Marku Kemi nevojë për rrugë me shkuar në shtëpi.

Z. Dod Prendi (Kalivare) Pastrimi me shpesh i mbeturinave , uji i pijshëm dhe ura janë domosdoshmeri.

Mbajtësi i procesverbalit

Figjete Baci



Sekretari i Këshillit

Hazbi Terbuni



Procesverbal

Konsultim publik : *Ne Njesine administrative Luf-Qerret*

Data : 29.10.2024

Ora : 11:00

Vendi: Salla e njesise administrative Luf-Qerret

Numri i pjesëmarrësve : 25 vete 23 burra dhe 2 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultime publike per PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 , NJ.A.Luf-Qerret.

Pjesëmarrës : Rrok Dodaj , kryetar i Bashkise Puke, Ferit Rringaj , zv/kryetar, Altin Perdeda zv/kryetar, Denisa Meci, sekretare e pergjithshme, Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, Demir Syla drejtori i sherbimeve publike , Nail Alia , she fi sektorit te Tatim-taksave, Hazbi Terbuni , sekretar i keshillit bashkiak, Klaudio Filipi , administrator i Nj.A.Luf-Qerret.

Takimi drejtohet nga zv/ kryetari i Bashkise , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024 dhe prioritetet per vitin 2025, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoj qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z. Klaudio Filipi , administrator i njesise administrative Luf-Qerret: *sot po zhvillohet ky bashkebisedim per PBA 2025-2027 dhe kerkoj, qe gjithsecili te prezantoj prioritetet per fshatin e tij,*

Z. Ferit Rringaj : *Po shpalosim prioritetet per vitin 2025 dhe sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024. Kerkoj nga ana juaj , qe te shpreheni lirshem dhe te beni pyetje dhe ankesa qe keni.*

Z. Ndoc Bushi : *jane kryer investime , por kemi shume nevojë per rruget dhe mirembajtjen e tyre, pra duam te kete nje person ne cdo rruge per ta mirembajtur..*

Z. Gjovalin Herceku : *Ne Korthpule nuk jane bere investime per 8 vjet. Asfaltimi i nisur para shume vitesh nuk eshte perfunduar, shpresojme te perfundoje sipas projektit . Paisja e rrugëve me tabela informuese.*

Mungon uji per vaditje, sherbimi ne rruget e zones nuk ka punonjes sherbimi.

Z. Ded Lleshi, kryeplak i Pletit: Ndertimi i vijes kryesore te fshatit dhe sigurimi i dritave.

Z. Gjon Vasia : Sigurimi i ujit vadites, duhet te zevendesohen tubacionet e amortizuar.

z. Lorenc Pjetri: Raport institucionesh : Bashki-Ujesjelles -Hipoteke etj. Kemi nje pune per te kryer por nuk e dime kush e ka kompetence per ta kryer.

Zj. Fiqirete Latifi: Kerkesat tuaja para nje viti ne jemi munduar t'i realizojme , per ujesjellsin per tabelat, rruget do te duhej nje buxhet , kemi tentuar per te bere diçka por plotesisht nuk kemi arrit.

Z. Ferit Rringaj: Vemendja e Kryetarit per kerkesat tuaja ka qene maksimale, per investime e sherbime dhe nuk do te mungoje edhe ne te ardhmen.

- Mirembajtja rutine e rrugeve
- Shqetesim ka qene furnizimi me energji.
- Legalizimet jane nje problem tjeter.
- Ujesjellesi , jemi ne kontakt per nje projekt te ri.


Mbajtësi i procesverbalit

Fiqirete Baci



Sekretari i Këshillit

Hazbi Terbuni



Procesverbal

Konsultim publik : *Ne qytetin Puke*

Data : 08.11.2024

Ora : 13:00

Vendi: Salla Leksioneve Pallati i Kultures Puke

Numri i pjesëmarrësve : 30 vete 24 burra dhe 6 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultime publike per PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 , ne qytetin Puke.

Pjesëmarrës : Rrok Dodaj , kryetar i Bashkise Puke, Ferit Ringaj, zv/kryetar, Altin Perdeda zv/kryetar, Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, Demir Syla drejtori i sherbimeve publike , Nail Alia , shefi sektorit te Tatim-taksave, Gjon Gjoka, kryetar i keshillit, Hazbi Terbuni , sekretar i keshillit bashkiak,

Takimi drejtohet nga kryetari i Bashkise , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024 dhe prioritetet per vitin 2025, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën , diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z. Rrok Dodaj : Po shpalojmë prioritetet per vitin 2025 dhe sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024.

- Problem shqetesues mbetet punesimi, por duhet thene se Bashkia ka nje problem te trashегuar nga paraardhesi , nje borxhe , qe krijon mjaftё veshtёrsi per vijimsine e puneve. Borxhi eshte i konsiderueshem rreth 700 milion leke.
- Hartimi i projekteve eshte ne vemendjen e bashkise per te realizuar investime dhe per te krijuar mundesi punesimi.
- Me mjaftё rendesi do te jete zhvillimi i turizmit , per te siguruar nje zhvillim te qendrueshem.
- Kemi shtuar mjaft aktivitetet artistike (trefishuar)

- Jane kryer me efikasitet shërbimet në qytet. Po zbatohet projekti për fasadat e 5 pallateve dhe do të vijojmë me palatet e tjera, do të nderhyjmë me rikostruksionin e shkolles muze Migjeni, do të asfaltohet rruga hyrese e qytetit. Do të punojmë në rivitalizimin e liqenit të Kukajve dhe t'i lidhim të dy liqenet.
- Do të nderhyjmë me investime në spitalin e qytetit.
- Do të rrisin bashkëpunimin me shoqatat dhe organizatat joqeveritare. Jemi të hapur për të degjuar ankesat dhe kërkesat tuaja.
- Një sqarim për rritjen e pagave: Jane rritur konformë VKM perkatese.

Zj. Fiqirete Latifi: Buxheti ka ardhur me një rritje 5%, por borxhet na kanë detyruar që të miremenaxhojmë buxhetet dhe kemi arritur të likujdojmë një pjesë të borxhit.

Z. Pjeter Gjoni : Si do të lahet borxhi?

Zj. Fiqirete Latifi: do të shikohet mundësia financiare.

Z. Rrok Dodaj: kemi vështërsi, por po përpiqemi për likujdimin e borxhit. Do të kemi si prioritet zhvillimin e turizmit. Kështu kemi bashkëpunuar me familjen Xhauri, e cila do të ndërtojë një objekt të rendesishëm për zhvillimin e turizmit në Pukë.

Z. Gezim Kopani: A janë të adresuara investimet?

Z. Rrok Dodaj: Bashkia funksionon si institucion dhe bën vazhdimisht transparencë.

Zj. Fiqirete Latifi: ka një grup strategjik që është i përbërë nga drejtoret. Buxheti faktik është transparentë në WEB.

z. Gezim Kopani : Si jep garanci Bashkia për larjen e këtij borxhi?

zj. Fiqirete latifi: Ka një plan menaxhimi rrisht.

z. Rrok Dodaj : Bashkia funksionon dhe do të bëjmë me të mirën e mundshme që të menaxhojmë të ardhurat. 5% janë 150 milion leke të vjetra dhe kjo degjëse na jep mundësi se si t'i shfrytëzojmë këto leke. Në jemi Bashki pilot dhe do të ngrihet struktura e vecante ndër 6 bashkitë pilot për të marrë fonde direkt nga BE përmes projekteve pa ndërmjetësim të qeverisë.

Zj. Fiqirete Latifi: Kjo struktura do të ketë një përfaqësues nga Ministria dhe 4 përfaqësues nga stafi i Bashkisë.

Z. Rrok Dodaj: Prioritetet do të jenë të parat për nderhyrje me investime, rruget e fshatrave do të behen të aksesueshme , por hapsirat ligjore po na pengojnë.

Në takimin e fundit me Ministrinë e mbrojtjes kam diskutuar për të gjetur hapsirë ligjore për t'i bërë të aksesueshme , që besoj se do të bëhet përmes planit të emergjencave civile. Jemi duke mbyllur planin e emergjencave civile dhe planin e menaxhimit të pyjeve. Jam në dijeni të infrastruktures se të gjitha lagjeve dhe kemi përgatit projekte për to.

Z. Agron Laçi: jam i kenaqur për arritjet e tua dhe sa të kështu mundësi për Pukën dhe jepi këtij populli, që edhe ai të të jap perseri votën.

Z. Prend Marku : Duke pas parasysh zhvillimin e Pukes te them te lumte. Nuk e kuptoj se si e kane bere punen pa produktivitet. Gjeja me e mire eshte miratimi i fillimit te punes ne pallatet. Megjese ka filluar puna ishalla hiqen merimangat e qytetit si kablloret dhe telat elektrik Per vitin 2025 them te keni nje plan te vecante per emergjencat.Po u realizuan ato qe the ke noten 10. Ju lutem mos e harroni pallatin tone.

Z. Rrok Dodaj: Nuk do te leme pas dore pallatin tuaj.

Z. Gezim Kopani: Ne jemi ketu per te degjuar dhe per te pyetur.

A ka kjo degjese nje grup drejtues pune? Aty eshte nje poster , a eshte kjo nje degjes e sponsorizuar?

Permenden punime qe jane te dobeta , q pergjigjen organet perkatese ne Bashki?

Nuk degjova adresim te problemit? Premtimet qe jane dhene sa jane mbajtur? Keto pune a do te vazhdojne ne 2025? Grand i Bashkise 5% me shume , ku keni menduar qe ti perdorni? Si me garanton Bashkia qe nese vendos permbarimi sekuestro , si do te menaxhoje Bashkia? Ne faqen e Bashkise nuk ka transparence? A ka grup pune qe menaxhon ankesat e qytetareve dhe kush jane ato.?

Z. Mustaf Mehaj(kryetar i fshatit Puke): Do te kisha pase deshire qe kjo degjese te behej pas ores 16.⁰⁰. Do te deshiroja qe te ishin prezent dhe banoret e lagjeve qe une perfaqesoj. Si do te veprohet me fondet per lagjet e fshatit Puke? Si asfaltim, ndricim dhe investime te tjera.

Z. Rrok Dodaj : Ndricimin do ta bejme.

Z. Mustaf Mehaj : Te ndihmohen lagjet me projekte te ndryshme.

Z. Rrok Dodaj : lagjet nuk do t'i leme pasdore se me mujt i dua si qytetin dhe do te nderhyje fort me organizata , shoqata dhe fonde te Bashkise. Puka si bashki Pilot do te jete shembull per terheqjen e fondeve. Puna dhe besimi do te jene te panderprere. Ekipin e Terbunit do ta nxjerrim ne shitje, ndersa shtepia e oficerve eshte fituar nga nje biznemen. Do te bejme reabilitimin e varrezave te qytetit. Kam mendimin te bejme varrezat e reja dhe do te shohim mundesine e nje vendi te pershtatshem. E mendoj poshte Qafes se Qerretit si vend i bollshem dhe i pershtatshem. Se shpejti do te shohin perkufizimin e vendit , nuk kemi kosto ekstra dhe behet me shpenzimet e Bashkise. Perfundimi i pallateve eshte i garantuar. Se shpejti do te kemi prezantim projektesh te tjera.

Mbajtësi i procesverbalit

Besmira Mehaj



Sekretari i Këshillit

Hazbi Terbuni



Procesverbal

Konsultim publik : *Ne Njesine administrative Qelez*

Data : 19.11.2024

Ora : 10:00

Vendi: Salla e njesise administrative Qelez

Numri i pjesëmarrësve : *23 vete 20 burra dhe 3 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Konsultime publike per PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 , NJ.A.Gjegjan.*

Pjesëmarrës : *Ferit Ringaj zv/kryetar, Gjon Gjoka kryetar i keshillit te Bashkise, Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, Demir Syla drejtori i sherbimeve publike , Nail Alia , shefi sektorit te Tatim-taksave, Hazbi Terbuni , Bibe Kolaj, administrator i Nj.A Qelez.*

Takimi drejtohet nga zv/ kryetari i Bashkise , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024 dhe prioritetet per vitin 2025, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën , diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z. Ferit Rringaj : Po shpalosim prioritetet per vitin 2025 dhe sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024. Sot administrata e bashkise eshte ketu per te degjuar ankesat dhe kerkesat tuaja. Jemi ketu per te degjuar ankesat tuaja dhe te angazhohemi per zgjidhjen e tyre.

Ne kemi disa projekte per kete njesi si projekti per fshatrat Levrushk, Bushate dhe Buzhale dhe vitin tjeter do te jene ne zbatim.

Ankesat dhe kerkesat tuaja do te jene pasqyrim i punes tone.

Projektbuxheti eshte ne faze detajimi.

z. Ndue Marku: Rruga e kishes dhe e Bushatit jane madhore per ne, qe e kemi ngritur prej kohesh , por nuk jane realizuar.

Z. Gjovalin Marashi, kryetar i fshatit Bushat Duhet suvatuar rezervuari vadites , pasi rrjedh ujin dhe nuk mbushet me uje. Kemi nje familje me tre femije jetim , qe duhet me ndihmu me nje sasi te hollash.

Z.Sokol Gjoni : Eshte rast qe e njohim dhe do te shohim mundesine e ndihmes me shoqata ose nga Bashkia.

z. Besmir Marku : Rruga kembesore dhe dy ura ne fshatin Buzhale, duhen derrasa per punimin e tyre.

z. Ded Qeleshi: Nuk ka investime ne Qelez , punetoret e sherbimit jane punetor fushate.

z. Ferit Ringaj: Kryetari u jep emrin qe te punohet,Nuk ka preference per asnjerin. Drejtimi dhe punet administrohen nga njesia.

Z. Ded Qeleshi: Kam ngrit komision per punetoret tane dhe asnjeri nuk gjendej ne pune.

Z. Ferit Ringaj: E them me kompetence , qe kjo gje nuk eshte reflektuar ne ditet e punes. Nuk jemi qe te mbajme ne pune njerez , qe nuk punojne. Kryetari na ka besuar nje pune, qe duhet ta bejme me pergjegjesi, nuk kemi te perzgjedhur.

z. Ded Qeleshi: Punetoret te kercenojme dhe nuk merrem me to.

Z. Ferit Ringaj : Takim urgjent per kete problem.

z. Sokol Gjoni: Nuk jemi vene ne dijeni per kete rast.Ti si pergjegjes duhet ta kishe marr parasysh kete rast dhe zgjidhjen e ketij problemi. Nuk e ke patur te lehte. Duhet te kemi nje informacion dhe t'i jepni zgjidhje ketij problemi.

z. Ded Qeleshi: Ne komunen tone nuk ka 8 ore pune por 1 ore.

Z. Nikoll Deda: Nuk jam dakort me Deden, nuk jane te gjitha keshtu, ndonje rast te vecant, por duhet thene me emer. Rruga e fshatit tone ka nevojte per nderhyrje me nje fadrom. Disa ura jane te rrezikshme , eshte nje ure e pakalueshme. Tri ura kane nevojte per riparim, i kane bazamentet, nje ure nuk kalohet kur bie shi. Varrezat duhen rrethuar, uji vadites duhet riparuar kanali 2200 m dhe krah nuk behet, duhet te perdoret tub dhe te marren dy burime., ura e Lum Priftit ne Qelez duhet te riparohet.

z. Gjon Gjoka : Keni te drejte por disa gjera jane te paarriteshme.

z. Besnik Shkreli: Eshte turp me shqetesu kryetarin, sepse shumicen prej tyre nuk i njeh kryetari. Jena te gatshem te punojme kudo.

Z. Sokol Gjoni: Se nuk kerkon llogari dikush qe e ka per detyre.

Mbajtësi i procesverbalit

Besmira Mehaj



Sekretari i Këshillit

Hazbi Terbuni



Procesverbal

Konsultim publik : *Ne Njesine administrative Rrape*

Data : 05.11.2024

Ora : 11.⁰⁰

Vendi: Salla e njesise administrative Rrape

Numri i pjesëmarrësve : 18 vete 15 burra dhe 3 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultime publike per PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 , NJ.A.Gjegjan.

Pjesëmarrës : Rrok Dodaj , kryetar i Bashkise Puke, Denisa Meci, sekretare e pergjithshme, Altin Perdeda zv/kryetar, Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, Demir Syla drejtori i sherbimeve publike , Nail Alia , she fi sektorit te Tatim-taksave, Hazbi Terbuni , sekretar i keshillit bashkiak, Pellumbesha Lasku , administrator i Nj.A.Rrape.

Takimi drejtohet nga kryetari i Bashkise , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024 dhe prioritetet per vitin 2025, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoj qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z. Rrok Dodaj : Po shpalosim prioritetet per vitin 2025 dhe sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2024.

- Nuk kemi ndonje buxhet te madh por po hartojme projekte ne kuader te funksionimit te institucionit. Po bejme projekte per rruge, sherbime ne pyje, prita malore etj dhe te punesohen sa me shume banore.
- Kerkojme te degjojme nga ju problematika konkrete , te domosdoshme qe te mund t'i planifikojme dhe t'i zgjidhim. Ketu do te flasim per te gjithë sektoret si arsim, shendetesi dhe sherbime te tjera, qe ndihmojne ne rritjen e cilesise se jetes.

- Rritja e pagave është bere sipas VKM perkatese dhe ka perfshire administratoren , por jo punonjesit e sherbimeve.
- Kryetaret e fshatrave paguhen ne vartesi te pages se administatores dhe duhet te kryejne detyren e tyre.

Z. Mark Frroku , Bicaj: Kemi nevojë për ujë, ujësjellës , drita dhe për fadrom kur rruget bllokohen.. kemi shumë probleme me dritat dhe nuk dime kush është elektrikist.Për 14 vjet nuk është bere asnjë investim në rrugë etj.

Z. Bledar Qollaku, kabash: Për energjinë nuk ka vënë kush dorë. Problem kemi me ujin, rruget kanë nevojë për nderhyrje. Ujësjellësi i Pukës kalon në Kabash dhe shkon deri në Luf dhe në nuk kemi ujë.

Z. Mustaf Furriku, Mece, Kemi mungesë të ujit, ka disa familja , që u është heq ndihma ekonomike, nuk shohim dot lajmet.

Z. Pal Suli (Lumzi): Rruget janë problematike, lidhja e ujit ka nevojë për nderhyrje , bëhet fjalë për 600-700m.

z. Rrok Dodaj: Po bëjme përpjekje për hapjen e rrugëve por nuk kemi arrit me marrë lejet, po bëjme planë për menaxhimin e pyjeve dhe emergjencave dhe besoj d tja dalim.

z. Mustaf Furriku: Duhet të ketë punëtor shërbimi për këto rrugë që të mbahen të hapura.

Z. Pashk suli(Lumzi) Sigurimi i ujit është i mundur, pasi e kemi patur për 30 vjetësh ujë . Ujë, drita kemi nevojë.

Z. Rrok Dodaj: Problemin e rrugëve do ta zgjidhim duke bere planin e emergjencave civile, përvec kësaj do të punojmë për përcaktimin e atraksioneve turistike , që do të krijojnë mundësi përmesimi e zhvillimi.

Z. Mark Matia: Rruga ka nevojë për 10m 3 gure për të riparuar murin që është shembur. Fshati ka patur 90 shtëpi dhe kemi patur ujë , ndërsa sot jemi 20 shtëpi dhe nuk kemi ujë, ndoshta duhen vendosë shtatet dhe njërezit të paguajnë sa hargjojnë. Ura pasarele duhet riparuar.

z. Nikoll Thekna: Ura pasarele të riparohet. Uji është problem. Rrethimi i varrezave.

Zj. Pellumbesha Lasku: Do të shtojmë përpjekjet dhe bashkëpunimet për realizimin e kërkesave dhe ankesave.

Mbajtësi i procesverbalit

Fiqirete Paci



Sekretari i Këshillit

Hazbi Terbuni

